



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2343/2 Prot.

Tiranë, më 14.10 2025

V E N D I M

Nr. 250 Datë 14.10. 2025

PËR

SHPLLJEN E KONKURISIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË
PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanit të FSHR me nr. 2343/1 prot., datë 13.10.2025, "*Kërkesë për hapjen e konkursit për punësimin e 1 (një) Asistent Lektor me kohë të pjesshme, pranë Departamentit të Kineziologjisë në FSHR*", Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në Web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI KINEZIOLOGJISË

- 1 (një) Asistent Lektor
- Lënda: "Mjekësi Fizike, Diagnostikim"
 - Moduli : "Fiziologji e Njeriut", (Bachelor)

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Asistent Lektor", Lënda: "Mjekësi Fizike, Diagnostikim" dhe për Modulin: "Fiziologji e Njeriut", (Bachelor), në Departamentin e Kineziologjisë janë si më poshtë:

II. KRITERE TE PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në percaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohe të plotë në UST;
2	Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;

3	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
4	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri); Në asnjë rast kandidati nuk duhet të ketë note mesatare më të ulët se 8 për çdo cikël studimi. d.1. Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8 . d.2. Për çdo 0.1 note më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pike në vlerësim, gjithsej 10 pikë. d.3. Përfshihen nga kërkesa e pikës d.1), vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
5	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht). Përfshihen nga kërkesa e pikës 5, vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

Kritere specifike:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare për mjekësi. Duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar, me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Të ketë të paktën 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e mjekësisë.
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
4. Vlerësohen specializime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së mjekësisë.

III. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penalteti/ formulari i vetëdeklarimit);

- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

IV. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit në **rruge elektronike ne web-site te UST-se dhe ne menyre postare:**
- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Njësia Kryesore, Njësia bazë, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

V. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pese) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pese) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare ose të gjithë paketën me dokumenta e dërgon elektronikisht ne web-site te UST .

- VI. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VII. Deri në datën 22.10.2025, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 24.10.2025 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë pune.
- VIII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- IX. Dekanati i FSHR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 29.10.2025, për miratim në Rektorat.
- X. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

